

VENDIM
Nr. 53, datë 7.3.2018

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “SONNE” SHPK, PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK
TOPOJË, ME FUQI
TË INSTALUAR 1998 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a”; të nenit 8; të nenit 10, pika 2 dhe 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, mbi mosfillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, shoqërisë “Sonne” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 3 prot., datë 1.2.2018, protokolluar në ERE me nr. 149 prot., datë 2.2.2018, shoqëria “Sonne” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë.

- Shoqëria “Sonne” sh.p.k., ka paraqitur autorizim paraprak me afat 6 muaj me nr. 4867/6 prot., datë 27.10.2016, që i është bashkëlidhur dokumentacionit të studimit të fizibilitetit.

- Autorizim me nr. 4867/6 prot., datë 27.10.2016, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nuk i përket subjektit që ka aplikuar për licencë shoqërisë, “Sonne” sh.p.k., por shoqërisë “Albanian General Elektrisity” sh.p.k.

- Në bazë të nenit 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”, theksohet se akti administrativ i cili i jep mbajtësit të saj të drejtën për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, miratohet nga ministri, për objektet deri në 2 mw, ndërsa mbi 2 mw, nga Këshilli i Ministrave.

- Shoqëria “Sonne” sh.p.k. nuk ka depozituar pranë ERE-s një kontratë të lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe miratimin përfundimtar të ndërtimit.

- Aplikimi i shoqërisë “Sonne” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”), paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a” dhe “b”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për Impiantin Fotovoltaik (neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3, gjerat “a”, “b”, “d”, pika 4.4.4, gjerat “a”, “b”, “d”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “f” (marrëveshje ose autorizimi nga KM-ja); germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekt);

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) dhe germa “d” (vërtetimin e pagesës për aplikim në llogari të ERE-s, e kryer pjesërisht);

- Neni 9, pika 4.4.3, germa “c” (shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria); pika 4.4.4, germa “c” (oponenca teknike e projektit); germa “e” (miratimi i zbatimit të projektit nga MIE) dhe pika 4.4.5 (leje nga institucione të tjera),

do të njoftohet subjekti që në zbatim të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato në ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Sonne” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, me fuqi të instaluar 1998 kw.

2. Nëse shoqëria “Sonne” sh.p.k. paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6, të nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda 1 muaji nga marrja e këtij vendimi dokumentacioni i vlefshëm i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi